



Në bazë të nenit 8, nenit 3a, 3b, 3c dhe nenit 6 të Ligjit mbi eksproprijim , Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 21/76, 45/86 dhe nr. 25/89, të nenit 3 të Rregullores mbi qeverisjen e komunave të Kosovës 2000 /45 dhe të nenit 19 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.05.2006, merr

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE NR. 823/1, ZONA KADASTRALE MATIÇAN, E EVIDENCUAR NË FLETËN POSEDUESE NR. 389, TOKË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e pjesës së ngastrës kadastrale nr. 823/1 , zona kadastrale – Matiçan, e evidencuar në fletën poseduese nr. 389, tokë me interes të përgjithshëm, me qëllim të realizimit të planit urbanistik dhe ndërtimit të shkollës në Lagjen e Spitalit.

Neni 2

Ngastra kadastrale, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi , përfshin tokën e cila gjendet në pronësi shoqërore, me pronar KBI “ KOSOVA EXPORT ”, e cila sipas të dhënave të aparatit kadastral ka sipërfaqe prej 3.02.65 ha, ku brenda kufijve të kësaj parcele është paraparë të ndërtohet shkolla.

Neni 3

Fillon procedura e eksproprijimit të tokës së shpallur me interes të përgjithshëm sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Procedura e eksproprijimit të tokës së përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të zhvillohet nga Drejtorati i Financave dhe i Pronës i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprimet e tij procedurale nga përgjegjësia e tij e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr.952-210, më 04.05.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri